

SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	“Teknik i mesëm (Hidrualik/Kaldaist)”	Rep. usht. nr.1002 Zall-Herr FT	Pajet, Bizë, Shëngjergj Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	24.01.2025	07.02.2025

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës:	“ Teknik i mesëm (Hidrualik/Kaldaist) ”, me pozicion “CII”, në skuadrën e mirëmbajtjes, toga e ruajtjes (Pajet, Bizë), kompania e ruajtjes dhe sigurisë, reparti ushtarak nr.1002, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-045 (Pajet, Bizë, Shëngjergj), kod grupi D, numër paragrafi 12, numër rendor 003 dhe specialitet LR 2400.
2. Kodi i pozicionit:	C2, (Civil II).
3. Reparti/Institucioni:	Reparti ushtarak nr.1002, në Forcën Tokësore.
4. Vendi:	Pajet, Bizë, Shëngjergj, Tiranë
5. Paga:	VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit:	24.01.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit:	07.02.2025
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	- Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare, të noterizuar ose në origjinal. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit. - Dëshmi profesioni hidrualik - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja nëse ka. - Raport mjeksor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:	- Të ketë shtetësinë shqiptare.

- Të jetë jo më pak se 18-vjeç.
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara.
- Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore.
- Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil II, (C2).
- Arsimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesionale.
- Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara. Preferohen me dëshmi të kursve profesionale (Hidraulik), si dhe të jetë me vendbanim në Shëngjergj.
- Trajnimi: Të ketë trajnime të ndryshme për hidraulik/kaldaist.
- Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- Gjuha e huaj: Nuk preferohet
- Kërkesa të tjera specifike:
 - Të ketë kurse kualifikimi për specialitetin e kërkuar.
 - Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- Niveli i certifikatës së sigurisë: -----.

13. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: “**Teknik i mesëm (Hidraulik/Kaldaist)**”, me pozicion “CII”, në skuadrën e mirëmbajtjes, toga e ruajtjes (Pajet, Bizë), kompania e ruajtjes dhe sigurisë, reparti ushtarak nr.1002, në Forcën Tokësore, me kod vendndodhje A-045 (**Pajet, Bizë, Shëngjergj**), kryen këto detyra dhe mban përgjegjësi:

- Përgjigjet për gadishmërinë teknike të rrjetit hidraulik dhe instalimeve hidrosanitare të Qendrës Stërvitore Pajet, Bizë si dhe për gadishmërinë teknike të kaldajës në sallë dhe në rrjete për funksionim normal të furnizimit me ngrohje.
- Të njohë, zotërojë e të mbajë në gadishmëri mjetet, pajisjet që ka në ngarkim.
- Të zbatojë në kohë detyrat si hidraulik/kaldaist/Çbllokuesit, sipas rregullave përkatëse.
- Të jetë i pajisur me të gjitha dokumentat e përcaktuara për funksionin organik.
- **Detyrat si Kaldaisti**
 - Kaldaisti nga ana teknike ka varësi direkte nga sektori teknik.
 - Ndjek dhe përgjigjet për gadishmërinë teknike të kaldajës në sallë dhe në rrjete për funksionim normal të furnizimit me ngrohje.
 - Të njohë dhe të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjen kundra zjarrit në vendin e tij të punës.
 - Të gjitha defektet e vogla të cilat nuk kërkojnë pjesë këmbimi, riparohen nga vetë kaldaisti, për të tjerat rakordon punën me inxhinierin mekanik.
 - Kryen detyra të tjera të caktuara nga eprorët
- **Detyrat si Çbllokuesit**
 - Çbllokuesi ka varësi direkte nga sektori teknik
 - Ndjek dhe përgjigjet për gadishmërinë teknike të rrjetit të shkarkimeve të ujërave të bardha e të zeza në institucion. Koordinon punën edhe me hidraulikun.
 - Të njohë dhe të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e tij të punës.

➤ **Detyrat e Hidraulikut**

- Hidrauliku ka varësi direkte nga nga sektori teknik
- Ndjek dhe përgjigjet për gadishmërinë teknike të rrjetit hidraulik dhe instalimeve hidrosanitare të Qendres Stërvitore.
- Të njohë dhe të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e tij të punës.
- Të jetë i aftë dhe të operojë për zgjidhjen e problemeve dhe defekteve të ndryshme
- Monitoron furnizimin/konsumimin dhe konstaton ndërprerjen e furnizimit me ujë brënda godinave të Qendres Stërvitore dhe përreth saj.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për zbatimin e rregullave gjatë përdorimit të sistemit Kladaist/Hirualik.

Përgjigjet për gatishmërinë e mjeteve që ka në ngarkim.

Përgjigjet për gadishmërinë teknike të rrjetit hidraulik dhe instalimeve hidrosanitare të institucionit si dhe për gadishmërinë teknike të kaldajës në sallë dhe në rrjete për funksionim normal të furnizimit me ngrohje.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.

SHEFI I DEGËS PERSONELIT

Nënkolonel Xhemil Hurdha